



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:139067

Datë: 17.04.2024

Numri i dokumentit: 05585491

**PPP.nr.164/22**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESco), me seli në Prishtinë, rr “...”, nr...., kundër debitorit H.M. nga fsh ..., Komuna e Ferizajt, për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 17.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit H.M., i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.201/2022, i datës 23.06.2022, i lëshuar nga përmbaruesi privat Sh.L. nga Ferizaj dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.201/2022, i datës 23.06.2022.

**A r s y e t i m**

Me urdhrin P.nr.201/2022, të datës 23.06.2022, përmbaruesi privat Sh.L., e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESco), kundër debitorit H.M., për pagesën e shumës së borxhit prej 692.88 euro, në bazë të ekstraktit të librave afariste me numër DFE ..., të datës 21.06.2022, si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbarimore, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe nga xhirollogaria e debitorit të barten në xhirollogarinë bankare të përmbaruesit privat ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta pranoj prapësimin si të bazuar dhe ta anuloj urdhrin për përmbarim.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbaram P.nr.201/2022, i datës 23.06.2022.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin mbi lejimin e përmbaramit P.nr.201/2022, të datës 23.06.2022 dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Po ashtu, Gjykata vlerëson se urdhri i atakuar me prapësim nga debitori, me numër P.nr.201/2022, i datës 23.06.2022, është i ligjshëm dhe i rregullt, dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbaramore, ngase përmbaruesi privat në këtë rast e ka lejuar përmbaramin në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 29, par 1, nën par 1.2, të LPP-së.

Sa i përket pretendimit të debitorit në prapësim se urdhri për përmbaram është i kundërligjshëm por jo edhe human, për arsye se dokumenti përmbaramor i cili ka shërbyer si bazë për këtë urdhër është lëshuar në kundërshtim me ligjin, Gjykata këtë pretendim e konsideron të pabazuar sepse siç vërtetohet nga shkresat e lëndës, Përmbaruesi privat Sh.L., urdhrin e atakuar me prapësim, e ka nxjerrë në pajtim të plotë me nenin 29, par 1, nën par 1.2, të LPP-së, dhe duke u bazuar në ekstraktin nga librat afariste DFE ....., të datës 21.06.2022, i cili konsiderohet dokument i besueshëm në bazë të cilit organi përmbarues mund ta caktoj përmbaramin.

Gjithashtu, pretendimet e debitorit në prapësim se: kriteret e KEDS-it për mua si debitorë janë pak sa diskriminuese edhe pse nuk jemi kundër asaj që rastet sociale të lirohen nga pagesa e energjisë elektrike por kushtet tona si familje fare nuk janë marrë për bazë nga ana e kreditorit, unë si debitorë jetoj me pensionin bazë 100 euro e po ashtu edhe bashkëshorti im me po të njëjtën shumë prej 100 euro, që nuk janë të mjaftueshme për sigurimin e bukës së gojës e lere me për nevoja tjera për jetë. Për më tepër, bashkëshorti im është në gjendje shumë të rëndë shëndetësore e po ashtu edhe djali ynë është i sëmurë nga zorra e trash dhe nuk kemi ka të ja mbajmë, gjykata konsideron se edhe këto pretendime nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara, sepse pretendimet e tilla nuk janë pretendime të cilat bëjnë pjesë në grupin e shkaqeve të prapësimit të cilat janë paraparë në dispozitat e nenit 71, par 1, të LPP-së. Për më tepër, Gjykata vlerëson se debitori, duke e marr parasysht gjendjen e tij financiare, ka të drejtë që në pajtim me dispozitat e nenit 61, të LPP-së, nëse plotësohen kushtet ligjore, të kërkoj nga organi përmbarues, shtyrjen e përmbaramit deri në një afat prej gjashtë muaj.

Gjithashtu, Gjykata konstatoj se ekstrakti i verifikuar nga librat afariste DFE-..., i datës 21.06.2022, në bazë të cilit është nxjerrë urdhri i atakuar me prapësim, është i përshtatshëm për përmbaram, respektivisht në pajtim të plotë me nenin 29, par 3, të LPP-së, sepse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.

Përveç tjerash, Gjykata, bazuar në propozimin për përmbaram të kreditorit, periudhës kohore prej 12.05.2021 deri më datën 27.05.2022, për të cilën kreditori ka kërkuar shumën e borxhit prej 692.88 euro, si dhe llogaritjes së faturave për këtë periudhë kohore në bazë të ekstraktit të librave afariste, ka ardhur në përfundimin se shuma e borxhit prej 692.88 euro, e kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbaram, përputhet në tërësi me periudhën kohore të cekur më lart.

Gjithashtu, Gjykata konstaton se propozimi për përmbaram i kreditorit është në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 38, par 1, të LPP-së, respektivisht propozimi për përmbaram i kreditorit siç shihet e përmban kërkesën për përmbaram, dokumentin e besueshëm, siç është ekstrakti i verifikuar nga librat afariste në origjinal, kërkuesin e përmbaramit dhe të dhënat e debitorit, duke e përfshirë edhe numrin personal të letërnjoftimit të debitorit, si dhe të dhënat tjera të cilat janë të nevojshme për zbatimin e përmbaramit.

Si përfundim, duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim, thëniet e kreditorit në përgjigjen në prapësimin e debitorit, si dhe duke i marr parasysh provat dhe shkresat tjera të lëndës, Gjykata konstaton se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ndërsa urdhri për përmbaram P.nr.201/2022, i datës 23.06.2022, të mbetet në fuqi.

Andaj, Gjykata bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**PPP.nr.164/22, më datë 17.04.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.